



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	14.07.2025
REFERENC-Ë:	642-25-5069-5-1-1
PËR/ZA/TO:	Operatori Ekonomik: "RENEA GROUP" SH.P.K.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Zyra e Prokurimit - Kushtrim Mehaj – Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim për Aktivitetin e Prokurimit: "Ndërtimi i rrugës Cen Stantërgu - Bashkëfinancim me MAPL" me nr.prokurimi: 642-25-5069-5-1-1

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Mitrovicës Jugore në mbështetje të nenit 63.1.3 pika (b) të Rregullorës Nr.002/2024 për Prokurim Publik duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Operatori Ekonomik: "RENEA GROUP" SH.P.K., të datës 10.07.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugës Cen Stantërgu - Bashkëfinancim me MAPL" me nr.prok: 642-25-5069-5-1-1, kundër NJOFTIMIT për kontratë, dokumentet e tenderit të datës 05.06.2025, Autoriteti Kontraktues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtuar me datë 10.07.2025, nga Operatori Ekonomik: "RENEA GROUP" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i rrugës Cen Stantërgu - Bashkëfinancim me MAPL" me nr.prokurimi: 642-25-5069-5-1-1, kundër NJOFTIMIT për kontratë, dokumentet e tenderit e Autoritetit Kontraktues të datës 05.06.2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nëshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: "RENEA GROUP" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugës Cen Stantërgu - Bashkëfinancim me MAPL" me nr.prokurimi: 642-25-5069-5-1-1, ka bërë Kërkesës për Rishqyrtim me datë 10.07.2025 kundër NJOFTIMIT për kontratë, dokumentet e tenderit e Autoritetit Kontraktues të datës 05.06.2025, ku pas kërkesës për rishqyrtim OE ka kërkuar që ta tërheqë kërkesën për rishqyrtim të parashtuar nga ana e tij me arsyetimin se gjatë përpilimit të kërkesës për rishqyrtim ka gabuar procedurën sepse kërkesa e tyre ka qenë për një procedurë tjetër dhe jo për procedurën në fjalë dhe me këtë rast ka kërkuar që ta tërheqë ankesë-kërkesën për rishqyrtim:

Bazuar në të dhënat e lartëcekura Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe Legjislacionit sekondar të LPP-së.